

Ndërmarrja Publike për Furnizim me Ujë

“Studençica” – Kërçovë

Nr. protokollit: **02-590/1-2/2**

Datë: **25.03.2020**

Në bazë të nenit 26, paragrafi 1, pika 16 të Statutit të Ndërmarrjes Publike për Furnizim me Ujë “Studençica” Kërçovë, Bordi Drejtues i NP për Furnizim me Ujë “Studençica” Kërçovë, në mbledhjen e mbajtur më 25.03.2020, miratoi këtë:

RREGULLORE

për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për punën e Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike për Furnizim me Ujë “Studençica” Kërçovë nr. 02-1142/1-2/2, datë 09.06.2015

Në bazë të nenit 26, paragrafi 1, pika 16 të Statutit të Ndërmarrjes Publike për Furnizim me Ujë “Studençica” Kërçovë, Bordi Drejtues i NP për Furnizim me Ujë “Studençica” Kërçovë, në mbledhjen e mbajtur më 25.03.2020, miratoi këtë:

Neni 1

Me këtë Rregullore bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për punën e Bordit Drejtues të NP për Furnizim me Ujë “Studençica” Kërçovë nr. 02-1142/1-2/2, datë 09.06.2015.

Në Kapitullin 2 “Mënyra e punës së Bordit Drejtues”, pas pikës 2.6 “Shtyrja dhe ndërprerja e mbledhjes së Bordit Drejtues”, shtohet pika e re 2.7 “Mënyra e punës së Bordit Drejtues në rast të shpalljes së pandemisë dhe shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe krizës në shtet”, ku shtohet neni 39-a me këtë përmbajtje:

Neni 39-a

Bordi Drejtues mund të punojë dhe të marrë vendime në mënyrë të plotfuqishme gjatë gjendjes së shpallur të pandemisë dhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose krizës në shtet, nëse anëtarët e Bordit Drejtues materialet për mbledhje i marrin përmes postës elektronike dhe votojnë elektronikisht për propozim-vendimet e dërguara me e-mail çdo anëtar i Bordit Drejtues.

Vendimet e Bordit Drejtues konsiderohen të miratuara nëse për to, përmes postës elektronike, kanë votuar më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues.

Votimi elektronik realizohet me dërgimin e njëkohshëm të e-mailit te kryetari i Bordit Drejtues, drejtori i NP-së dhe te nëpunësi publik përgjegjës nga shërbimi profesional, në mënyrë që kryetari, përmes postës elektronike, t’i ftojë anëtarët të deklarojnë nëse janë “PRO” ose “KUNDËR” propozimit, ose “PËRMBAHEN” nga votimi.

Gjatë marrjes së vendimeve, çdo anëtar i Bordit Drejtues është i obliguar që gjatë votimit t'i arsyetojë veçmas arsyet e votës së tij, nëse akti për të cilin votohet nuk miratohet unanimitisht. Arsyet individuale për votimin detyrimisht regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes që zhvillohet në mënyrë elektronike.

Pas përfundimit të votimit elektronik, kryetari në mënyrë elektronike e konstaton rezultatin e votimit dhe ai regjistrohet në procesverbal.

Neni 2

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për punën e Bordit Drejtues të NP për Furnizim me Ujë “Studençica” Kërçovë nr. 02-1142/1-2/2, datë 09.06.2015, hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

25.03.2020
Kërçovë

Kryetar i Bordit Drejtues
Sait Abazoski